



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni Pranveror

Për: Komisioni për Legjislacion Mandate , Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsioni
Komisioni për Integritet Evropian
Komisioni për të drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Nga: Komisioni për Buxhet dhe Financa

Lënda: Raport me Amendamente për Projektligjin nr. 06/L-155, për ndalimin e lojërave të fatit

Datë: 29.3.2019

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Vendimit nr.06-V-337, datë 28.03.2019 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28.3.2019, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-155, për ndalimin e lojërave të fatit dhe raportin me amendamente e procedon në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës:

R a p o r t

Me amendamente për Projektligji nr. 06/L-155, për ndalimin e lojërave të fatit, me amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 1 **Qëllimi**

Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 2

Neni 2, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 2 Shfuqizimi

Me këtë Ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij.

**Kryetari komisionit,
Lumir Abdixhiku**